



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 04
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 303
Prishtinë, më 23 janar 2015, në orën 12:00.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Njomza Emini, Fadil Beka, Hatim Baxhaku, Besa Baftiu, Time Kadrijaj dhe Shukrije Bytyçi.

Munguan: Fikrim Damka, Adem Hoxha.

Stafi mbështetës i Komisionit: Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

RENDI I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Takimi njoftues me ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-MPMS, z. Arban Abrashi, diskutim lidhur me prioritetet dhe sfidat e ministrisë;
3. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Takimi njoftues me ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-MPMS, z. Arban Abrashi, diskutim lidhur me prioritetet dhe sfidat e ministrisë

Kryetarja, kemi kënaqësinë që në mesin tonë, për herë të parë, kemi ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Arban Abrashi. Ju faleminderit z. ministër për prezencën tuaj.

Komisioni, në mbledhjen e kaluar, ka vendosur që t'ju ftojë në takim, para se ne si Komision, të fillojmë me përgatitjen e planit të punës për vitin 2015. Pra, t'ju dëgjojmë fillimisht juve për sfidat dhe prioritet që i keni ju si Ministri për këtë vit. Komisioni ynë përbëhet nga përfaqësuesit e të gjitha partive politike që janë në Kuvend. Ne si Komision, jemi zotuar se do të bashkëpunojmë ngushtë dhe s'do të ketë ndasi politike. Për ne, si Komision, problemi kryesor është zgjidhja e çështjeve sociale, si dhe ndalja e migrimit që është duke ndodhur dhe krijimi i mundësisë së punësimit për ata që janë të papunë. Kemi shumë tema për të cilat jemi të interesuar, mirëpo pasi që është takimi i parë, s'do të thellohem tepër, sepse do të kemi takime të shpeshta ku ju si ministër do të raportoni para Komisionit. Ne si Komision, do të bëjmë mbikëqyrjen buxhetore sesi po shpenzohen mjetet, a po kemi ndërrim të destinimit të vijave buxhetore brenda Ministrisë, pasi që në të kaluarën ka pasur lëvizje të tilla, prej një kategorie, në kategorinë tjetër. Shpresojmë se do të kemi edhe përkrahjen tuaj, sa i përket kësaj çështjeje, me qëllim që ne si Komision, të bëjmë një mbikëqyrje sa më të mirë.

Arban Abrashi, Ministër i MPMS – Fillimisht, më lejoni t'ju falënderoj ju kryetare dhe gjithë anëtarët tjerë të Komisionit. Po ashtu, iu falënderoj edhe për ftesën dhe jam përgjigjur me kënaqësi, do të mundohem që para jush të prezantoj sfidat me të cilat përballemi ne si Ministri, gjithashtu edhe prioritet që i kam, si ministër i ri. Pra, është një ministri që ka një fushëveprim të gjerë dhe prek pothuajse kategoritë më të ndjeshme të shoqërisë sonë dhe besoj se do të kemi një koordinim të mirë edhe me dikasteret tjerë, duke përfshirë Ministrinë e Financave, gjithashtu edhe Kuvendin, në mënyrë që t'i adresojmë këto çështje dhe t'i trajtojmë në mënyrë sa më të mirë të mundshme këto kategori, të cilat më të vërtetë kanë nevojë.

Unë po filloj me prezantimin, fillimisht me programin legjislativ, mandej nëpër sektorë të caktuar që janë përgjegjësi e ministrisë. Ministria përfshin, nëse mund të themi, katër shtyllat kryesore. Atë që kam vërejtur unë prej marrjes së mandatit, pra analizave të para, mendoj se mund të punohet më shumë sa i përket fushës së punësimit dhe departamentit të punësimit, pra do të jetë me theks të veçantë puna rreth organizimit dhe përkrahjes të kësaj shtylle, duke mos anashkaluar edhe fushën e çështjeve sociale, pensione, familjet e dëshmorëve dhe kategorive tjera. Gjatë analizimit të çështjeve sociale, ne kemi ardhur tek një koncept-ide, duke u bazuar edhe te praktikat e rajonit, të gjitha kategoritë sociale të trajtohen me një ligj të veçantë, pastaj beneficionet apo kompensimet që i marrin. Pra, me një ligj të rregullohen këto kategori dhe varësisht se sa ne kemi fonde apo buxhet do të gjejmë një mënyrë që të gjitha kategoritë të përfshihen dhe të marrin kompensim dhe të mos i anashkalojmë. Në këtë rast, kemi marrë edhe një veprim, sa i përket Projektligjit për paraplegjikët dhe tetraplegjikët, i cili ka pasur një kosto prej 8 (tetë) milion eurosh, i cili nuk është hartuar prej Ministrisë, ne kemi kërkuar së paku edhe një muaj kohë, së paku për konsultime për gjetjen e mënyrës dhe mundësive të financimit, që të mos kemi ligje vetëm në letër e të mos kemi mundësi financiare për implementim, ku mund të shkaktojmë edhe ndjenjë të keqe te ato kategori, si dhe mund të përballemi me padi për realizim të drejtës së tyre. Një veprim tjetër që e kam marrë, ka qenë një transferim i fondeve brenda programit, pra te kategoria e të verbërve, për të cilët është miratuar ligji, por s'i kanë marrë kompensimet, pasi që s'ka pasur fonde, pra ka pasur suficit të mjeteve në disa programe tjera dhe ne kemi bërë transferim të këtyre mjeteve dhe e kemi mbuluar këtë kategori.

E kemi proceduar për në Qeveri, Projektligjin për Këshillin Ekonomiko- Social (KES), që më tepër ka të bëjë me organizimin dhe detyrimet e palëve në këtë këshill, si dhe qartësimi i çështjes së financimit për anëtarët e KES-it.

Kemi përgatitur koncept-dokumentin për Projektligjin për ndërmarrjet sociale, e cila është një praktikë e re evropiane. Ne kemi dy modele, të cilat janë implementuar nga ana e donatorëve në

Obiliq dhe në Fushë- Kosovë, të cilat kanë treguar sukses dhe kanë punësuar 15 deri 20 punëtorë, të cilët ende vazhdojnë të punojnë.

Plotësim-ndryshimi i Ligjit të punës, i cili do të jetë një nga pikat kryesore. Ne do t'i qasemi në mënyrë jashtëzakonisht serioze, pasi që është një nga ligjet më të ndjeshëm. Ka kërkesa të shumta për ndryshime, si çështje kryesore që është diskutuar është çështja e pushimit të lehonisë. Ne fillimisht do të bëjmë një studim, i cili do të mbështetet nga Banka Botërore dhe donatorë tjerë, me qëllim që të kemi një pasqyrë të qartë se cilat ndryshime mund të bëhen.

Qendrat për punë sociale, mendoj se këtu duhet të punojmë me organizata joqeveritare profesionale që i njohin çështjet sociale, pasi të bëjmë licencimin e tyre, të gjejmë mundësi të subvencionimit të tyre, sepse nëpër komuna kemi qendra të ndryshme me fëmijë të braktisur, femra të trafikuar, ku këto OJQ profesionale do të kishin kryer punën shumë më mirë sesa këto qendra për punë sociale që funksionojnë në kuadër të Ministrisë, ka një kosto, mirëpo nuk është shumë e madhe në krahasim me atë se sa probleme kishim mundur t'i rregullojmë në shoqëri. Ne kemi marrë një vendim për licencimin e këtyre OJQ –ve profesionale dhe do të përgatisim një kosto të saktë dhe do të shqyrtojmë gjetjen e mundësive buxhetore, qoftë brenda Ministrisë apo Qeverisë. Në këtë rast do të krijohet një komision profesional dhe do t'i shqyrtojmë aplikacionet e këtyre organizatave se kush dhe sa i përmbushin kushtet për t'i trajtuar këto kategori.

Po ashtu, çështje tjetër të çështjet sociale është edhe strehimi për familjet me nevojë. Ne kemi kërkuar një analizë se sa me të vërtetë kanë nevojë për strehim, ku në bashkëpunim edhe me donatorë, përmes një plani të qëndrueshëm, dy deri tre vjet, t'i përmbushim këto nevoja dhe të mos kemi më problem me këtë kategori. Në bazë të informatave apo statistikave që i kemi deri më tani, diku janë 800 deri 1000 familje që kanë nevojë për strehim.

Kurse të çështja e pensioneve, Ministria si e tillë ka kapacitete t'i trajtojë. Realisht, Ministria i procedon të gjitha kërkesat dhe skemat pensionale. Ne kemi filluar me përgatitjen apo nxjerrjen e aktit administrativ për kategorizimin e pensioneve, siç parashihet edhe me ligj, pensionistët e moshës, pensionistët kontributdhënës, në bazë të kohëzgjatjes në punë. Kjo çështje ka një kosto buxhetore dhe do ta trajtojmë me kujdes dhe do të përgatisim edhe një analizë financiare.

Përsëri do të rikthehem edhe njëherë te sektori i punësimit. Në këtë çështje do të fokusohem më tepër, sepse ka mundësi të punohet edhe më shumë. Po ashtu, kam vërejtur edhe një vullnet për bashkëpunim edhe me donatorët. Fatkeqësisht që s'kemi një buxhet për të mbështetur sektorin privat, sa i përket krijimit të vendeve të reja të punës. Si çështje kryesore këtu kemi themelimin e Agjencisë së Punësimit, e cila parashihet edhe me ligj. Sa i përket punësimit, kjo agjenci do të fokusohet në projekte konkrete, qoftë punësim afatshkurtër ose afatgjatë.

Gjithashtu, qendrat për trajnime profesionale, tregu i punës kërkon aftësi të veçanta, të cilat ne fatkeqësisht s'po mundemi të ju ofrojmë. Përmes trajnimeve apo shkollimit të shpejtë, t'ju përshtatemi kërkesave të tregut, si dhe t'i përgatisim të rinjtë për punë profesionale. Ne i kemi vizituar këto qendra dhe kam kërkuar nga to, si dhe nga Banka Botërore një vlerësim të nevojave për trajnime. Ne do t'i fuqizojmë këto qendra dhe do të ofrojmë shërbime profesionale dhe shërbime çfarë kërkon tregu.

Departamenti i Punës do të shndërrohet në Agjenci të Punësimit dhe do të zhvillojë projekte të cilat janë në vazhdim për gjenerim të vendeve të reja të punës përmes bashkëpunimit me ministritë tjera dhe me partnerë tjerë. Jemi duke përgatitur projektin së bashku me Bashkimin Evropian për subvencionim të punësimit, qoftë subvencionimin e punëtorëve për një periudhë ku mandej ata vazhdojnë të punojnë qoftë subvencionimin e bizneseve për rritjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës, iniciativat për vetëpunësim. Kjo ishte në pika të shkurtra se çka kemi filluar të punojmë për këtë afat të shkurtër, prej kur kemi ardhur në krye të Ministrisë.

Flora Brovina – Ju faleminderit ministër për këtë prezantim. Ju urojmë punë të mbarë dhe suksese në përmbushjen e këtyre prioriteteve. Ne si Komision, do të organizojmë një tryezë lidhur me shpërnguljen e qytetarëve, me qëllim që t'i gjejmë faktorët ose motivet e kësaj shpërnguljeje masive dhe do t'i japim rekomandimet tona lidhur me këtë problem serioz. Kurse për Ligjin për veteranët e UÇK-së, a keni ndërmarrë ndonjë veprim?

Arban Abrashi, ministër i MPMS – Ne si Ministri i kemi kapacitetet e mjaftueshme dhe vetëm jemi duke i pritur listat apo verifikimin e tyre dhe ta procedojmë më tej.

Po ashtu, kemi biseduar me ambasadorin e Zvicrës lidhur me problemin e pensioneve të qytetarëve tanë që kanë punuar në Zvicër. Ambasadorja ka shprehur një gatishmëri për zgjidhjen e këtij problemi. Mirëpo, ata kanë marrë një vendim sa i përket pensioneve bazike, do t'i marrin vetëm ata qytetarë që jetojnë në Zvicër. Kanë shprehur një shqetësim të tyre se ka qytetarë që tashmë kanë vdekur dhe kanë vazhduar që të jenë përfitues të pensionit dhe në këtë rast kanë kërkuar një verifikim të gjithë atyre pensionistëve.

Flora Brovina – Ky problem është si rezultat i mungesës së marrëveshjes ndërshtetërore me Zvicrën dhe me Austrinë dhe shtetet tjera.

Fondet strukturale si ministri, a jeni të njoftuar dhe a keni filluar të bëni diçka?

Arban Abrashi, ministër i MPMS – Edhe kjo është pjesë e punës, siç e theksuam çështjen e punësimit dhe adresimin e punësimit. Ne jemi duke i përgatitur projektet të cilat kanë të bëjnë me punësimin. Njeri nga partnerët kryesor do të jetë Bashkimi Evropian, pasi që kemi një buxhet jo të mjaftueshëm. Bashkimi Evropian ka një buxhet për dhënie të fondeve për krijimin e politikave për punësim, pra krijimi i vendeve të reja të punës, qoftë përmes subvencionimit, qoftë përmes granteve apo trajnimeve. Ne kemi aplikuar në fondet strukturale të IPA - 2 në BE. Ne si ministri i kemi dhënë propozimet tona dhe jemi fokusuar në punësim. Pra, ne kemi hyrë në programin të IPA – 2 dhe duhet të dorëzojmë tash projekte konkrete për punësim. Ne po ashtu kemi hyrë edhe në planifikimin financiar të tyre.

Time Kadrijaj – Faleminderit kryetare, po ashtu ministër, faleminderit për prezencën tuaj. Atëherë pasi që është takimi i parë i Komisionit me ju si ministër, unë jam Time Kadrijaj, deputete e AAK-së, anëtare e Komisionit. Ju dëshirojmë punë të mbarë në punën tuaj. Ne ju shprehim gatishmërinë tonë për bashkëpunim dhe jemi të vetëdijshëm se është një sektor mjaft i ndjeshëm dhe përfshin kategori të shumta si pensionet, rastet sociale dhe kategoritë e tjera. Shpresoj se do të kemi një bashkëpunim të mirë mes nesh dhe Ministrisë suaj. Po ashtu, ju urojmë që ato prioritete që i prezantuat, t'përmbushni sa më mirë dhe të përmirësohet ky sektor dhe ne të mos iu kundërvihemi apo t'ju kërkojmë interpelancë parlamentare për mospunën e juaj.

Shukrije Bytyçi – Përsëritet për ministrin dhe për të gjithë anëtarët të Komisionit. Ne pamë një vullnet të mirë gjatë prezantimit të ministrit për prioritet dhe planin e punës së tij, si ministër. Mirëpo, ne kërkojmë që mundësisht të na dërgojë edhe në formë të shkruar planin dhe prioritetet që ne si Komision ta kemi më lehtë monitorimin e punës së tij. Shpresojmë që këto prioritete të jetësohen. Është e vërtetë se ka probleme të shumta. Sot nuk do të ngarkojmë apo nuk do të parashatrojmë pyetje, pasi që e dimë se po sa ka marrë mandatin e tij. Shpresojmë se ato që i qesim në letër, t'i zbatojmë, pasi që ne si shtet është e vërtetë se kemi ligje të mira në letër, por po ngecim në zbatim. Mandej kemi kategori të ndryshme ku ka persona që marrin social për gjendjen e tyre me aftësi të kufizuara e realisht nuk janë me aftësi të kufizuara.

Problem tjetër është se punëtorët e qendrave për punë sociale nuk qëndrojnë me koeficient të njëjtë në gjithë Kosovën. Mandej i kemi qendrat e HANDIKOS-it, që realisht nuk financohen prej buxhetit të Kosovës, por vetëm prej organizatave të ndryshme. Do të kishte qenë mirë të

shqyrtohet mundësia e pagesës së pagave të tyre prej buxhetit të Kosovës, menaxherëve të këtyre qendrave dhe qendrave apo shtëpive strehuese, siç janë në Mitrovicë, Gjakovë dhe Gjilan, të cilat i kam vizituar, kanë shumë vështirësi në sigurimin e buxhetit të tyre, por fatbardhësisht kanë mbështetje prej disa donatorëve. Po ashtu, shpresoj shumë që të përfundojë shpejt edhe strehimi për familjet pa strehë. Po ashtu, iu shprehim bashkëpunimin tonë në përmbushjen e këtyre prioritetëve të Ministrisë.

Hatim Baxhaku – Përhëndetje për ministrin dhe të gjithë ju të pranishëm. Unë s’do të zgjatem për t’i përsëritur gjërat të cilat veç u theksuan nga kolegët tjerë. Unë kam një paqartësi të deklarami i ministrit ku potencoi se të verbrit nuk i kanë marrë vitin e kaluar kompensimin për shkak të mungesës së fondeve në legjislaturën e kaluar. Unë i kam pas bërë pyetje ish-ministrit dhe ai është arsyetuar se fondet ekzistojnë, por nuk i kemi regjistrat e personave të verbër. Në k% të rasteve, cila është e vërteta, a nuk ka pasur fonde apo regjistrat kanë munguar?

Njomza Emini – Faleminderit kryetare. Po ashtu, faleminderit ministër për prezencën e juaj dhe mbresëlënëse për informatat që na dhe në këtë takim para Komisionit. Unë sinjerisht ju përgëzoj për këto iniciativa që i keni marrë. Unë jam shumë e shqetësuar me shpërndarjen e fondeve që sipas kategorive të ndryshme dhe sipas interesave të ndryshme përfitojnë disa kategori, e disa nuk përfitojnë. Lidhur me këtë çështje, si Komision na takon që të bashkëpunojmë ngushtë me ju sa i përket ligjit dhe të përgatisim një ligj të vetëm për të gjitha kategoritë që janë në Kosovë. Të sektori i punësimit ka qenë shumë e nevojshme që në mandatin e kaluar ka pasur mundësi që të punojnë shumë më shumë. Ne e dimë që ka donatorë dhe janë të gatshëm që të mbështesin ministrinë në këtë sektor, por ndoshta kanë munguar iniciativat apo projektet. Nuk kam çka të shtojë më shumë në këtë takim, përveç gatishmërisë së bashkëpunimit, sepse komisioni parlamentar nuk e ka rolin e vetëm të kontrollit apo mbikëqyrjes, po e ka edhe rolin e bashkëpunimit, jo vetëm të kritikojmë, por t’i ofrojmë edhe rekomandime dhe të përmirësojmë këtë sektor.

Fadil Beka – Faleminderit kryetare, përhëndetje ministër dhe ju kolegë. Unë jam Fadil Beka, anëtar i këtij Komisioni. Fillimisht të uroj për detyrën, është një detyrë shumë e rëndë, por në bazë të kësaj që prezantuat, në njëfarë mënyre, neve na ngjall pak shpresat që Qeveria, në veçanti ky sektor, do të punojë shumë seriozisht dhe unë në këtë nuk dyshoj. Siç e potencuan edhe kolegët, ne nuk do t’i shikojmë përkatësitë politike dhe do ta kesh mbështetjen tonë, si dhe do të angazhohemi maksimalisht në përmbushjen këtyre prioritetëve apo nismave që i prezantuat para nesh.

Besa Baftiu – Faleminderit kryetare, përhëndetje për ministrin dhe të tjerët. Unë paraprakisht skam qenë në dijeni se do të jetë ministri në Komision, pasi që në mbledhjen fundit s’kam qenë në mbledhjen e Komisionit. Pasi që është një takim informues apo njoftues në mes të ministrit dhe anëtarëve të Komisionit. Unë jam Besa Baftiu nga radhët e VV-së dhe për herë të parë jam deputete e Kuvendit. Edhe mua më erdhi shumë mirë që keni një vullnet dhe keni filluar qysh prej marrjes së mandatit t’i analizoni sfidat dhe t’i përcaktoni prioritetet pasi që udhëhiqni një ministri, e cila është ministria më e ndjeshme, sepse është kategoria e qytetarëve ku më të vërtetë janë në gjendje shumë të rëndë. Ne shprehim gatishmërinë tonë për bashkëpunim për përmbushjen e atyre projektligjeve dhe prioritetëve që i prezantuat. Po ashtu, edhe ne kërkojmë këto që çështjet që i prezantuat para nesh, të na dorëzoni edhe me shkrim, pra ndryshe është të prezantohen me gojë e ndryshe të dorëzohen edhe me shkrim, në mënyrë që t’ju monitorojmë në përmbushjen tyre.

Flora Brovina – Ministër, ju i dëgjua të gjithë deputetët e Komisionit, të cilët iu shprehën gatishmërinë për bashkëpunim dhe do të keni përkrahjen tonë. Jemi të kënaqur me atë që na prezantuat dhe besojmë se këso takimesh do të kemi me shpesh. Ju faleminderit.

Arban Abrashi, ministër i MPMS – Më lejoni t’ju falënderoj për zemërsisht për gatishmërinë për bashkëpunim dhe mbështetjen që na ofruat. Po ashtu edhe ne jemi të gatshëm që të raportojmë para Komisionit, sa herë që ju e vlerësoni.

Do të mundohem shkurtimisht t’u përgjigjem atyre pyetjeve apo shqetësimet që i shprehet ju si deputet. Te çështja e listave apo përfituesve të skemave sociale, ne do t’i rishqyrtojmë apo auditojmë me të vërtetë ka njerëz që s’e meritojnë dhe marrin, mirëpo do të kemi kujdes në këtë çështje, pasi që është edhe kompetencë e komunave.

Tek qendrat e punësimit në komunat, do të shqyrtojmë me ministrin e Financave që kur epen grandet qeveritare për komunat, t’i obligojmë komunat që një përqindje (%) 3 apo 5 %, t’i ndajnë për këto qendra apo çështje sociale, në mënyrë që çështjet sociale të mos jenë pjesë e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Çështje Sociale, por të jenë të ndara, e jo të jenë si çështje dytësore apo tretësire, pra të funksionojnë si drejtori e ndarë për çështje sociale.

Te zyrat e punësimit, i kam vizituar në fillim të mandatit dhe kam vlerësuar se nuk i kanë kushtet e punës për punë, duke filluar prej kompjuterit si pajisje, deri tek veturat ku iu pamundësohen vizitat nëpër biznese për mundësi diskutimi, për nevojat e bizneseve për punëtorë të rinj. Unë kam marrë një vendim që një numër të veturave të kabinetit tim, por edhe të Ministrisë, t’ua ndajmë këtyre zyrrave të punësimit, posaçërisht këtyre në Prishtinë, të cilat në mungesë të veturave, s’kanë mundur të realizojnë vizita nëpër biznese.

Kurse te kategoria e të verbërve, unë kam nënshkruar një vendim për transferim të një shume prej diku 1 milion euro, pasi që kohëve të fundit është rritur numri i tyre dhe s’ka pasur mjete të mjaftueshme në këtë kategori.

Shukrije Bytyçi – Faleminderit kryetare, desha edhe një çështje ta ngritë lidhur me zyrat e punësimit, ndoshta do të ishte mirë që zyrtarët të funksionojnë në kuadër të Drejtorisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, sepse kemi disa komuna që qytetarët as që janë të njoftuar që ekzistojnë zyrtarët e punësimit, në kuadër të komunave.

Arban Abrashi, ministër i MPMS – Ne jemi duke e hartuar projekt-rregulloren për Agjencinë e Punësimit dhe zyrat për punësim parashihen në secilën komunë. Pasi të nxjerrim këtë rregullore, ne do të zhvillojmë një fushatë informuese për qytetarët, që t’i njoftojmë për ekzistimin e këtyre zyrrave të punësimit. Këtu fonde nuk kishim për fushatë, por do të diskutojmë me donatorë dhe besoj se do të na mbështesin në këtë çështje.

Kryetarja – Ju faleminderit ministër, po ashtu iu falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 13:20.

E përqatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Flora BROVINA